



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

## SHPLLJE E REKRUTIMIT

**Kryetari i Komunës së Kaçanikut**, në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-149 për Ligjin e shërbimit Civil të Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, nenit 66.3 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 86 të Statutit të Komunës si dhe autorizimit të M.A.P-it shpallë konkurs për plotësimin e vendeve të punës:

### TITULLI I VENDIT TË PUNËS:

#### **I. ZYRTAR PËR PLANIFIKIM URBAN, RURAL DHE NDËRTIM**

Drejtoria për urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit

**Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës:** (Koeficienti 7)

**Numri i referencës së vendit të punës:** 06-101-4072/11

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Bën hartimin e planeve për vendosjen dhe ndërtimin si dhe cakton kushtet për ndërtimin e objekteve në përputhje me ligjin, si dhe mban evidencën e tyre.
- Organizon dhe koordinon punën në lëmin e planifikimit urban dhe rural,
- Bënë përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të planifikimit urban dhe rural
- Bën caktimin e kushteve për rregullim të hapësirës në bazë të planit urbanistik.
- Merr pjesë aktive në procedurat e planifikimit të hapësirës dhe rregullimit të tokës ndërtimore, planeve dhe programeve nga kjo lëmi.
- Jep shënime mbi madhësinë dhe destinimin e ngastrës kadastrale të caktuar ndërtimore, kompleksit të tokës dhe karakteristikat e parashtruara të ndërtimit.
- Merr pjesë në punën e komisioneve të ndryshme.

#### **II. ROJE PYLLI- 2**

Drejtoria për bujqësi, zhvillim rural dhe pylltari

**Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës:** (Koeficienti 4.5)

**Nr. i referencës së vendit të punës:** 08 -111-3907/11

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Legjitimon personat të cilët i takon në pyll duke kryer veprime kundërligjore apo në bazë të dyshimit për veprime të tilla.
- Kontrollon vendet e prerjes, deponimit dhe përpunimit të drunjëve.
- Ndalon automjetet transportuese në rrugë pyjore dhe publike dhe kontrollon ngarkesat e tyre me prodhime drunore.
- Bënë konfiskimin e përkohshëm të drunjëve me prejardhje ilegale, për veprimet e kundërligjshme njofton eprorin e vet.
- Në rast të shkakut të zjarrit ndërmer masat e nevojshme, njofton eprorin e vet dhe zjarrfikësit.

#### **Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Procedurat e konkurrimit:** Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

#### **Shkollimi i kërkuar:**

Për vendin e lirë të punës me nr. rendor - **I** - kërkohet **Fakulteti i ndërtimtarisë**

Për vendet e lira të punës me nr. rendor - **II**- kërkohet **Shkolla e mesme**

#### **Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:**

- Të kenë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi
- Të zotërojnë punën me kompjuter në lëmin apo programet përkatëse
- Preferohet të kenë përvojë profesionale

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin** Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe rregulloren Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

**Kohëzgjatja e emërimit :** Sipas ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës

**Data e mbylljes së konkursit;**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

**Paraqitja e kërkesave**

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores -**Zyra e pranimit**, kati përdhes dhe në web-faqen komunale .

**Kërkesat specifike:**

- Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten edhe këto dokumente:** Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes si dhe certifikata tjera mbi trajnimet e kryera.

***“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”***

***“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”***

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

**Kaçanik; 03.06.2011**

**Kryetari i Komunës  
z. Xhabir Zharku**